



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
Nr.01-060/01-12830/23 datë:23.05.2023



Npi – 01/216 datë: 31.05.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 31.05.2023, është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

I MBLEDHJES SË -V- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES  
Ë mbajtur më: 31.05.2023, (e mërkurë) në ora 9:00<sup>oo</sup> h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Sanije Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përvèç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Të gjithë Drejtoret, nga ZKF – znj.Kimete Ukaj, Nga OSBE, z.Mefail Mustafa, Shefja e Kabinetit znj.Anita Kurti, Asistente e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët e IT-së, Praktikantja, znj.Valmira Hoxha, Zyrtari për marrëdhënie me publikun z.Bajrush Rrahmani, nga RZSH – z.Muhamet Hoxha.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Pyetje -- përgjigje,
2. Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave,
3. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026,
4. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri.
5. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë, 2023/2024,
6. Propozim për ndryshimin e nenit 3 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë Npi-01/60 dt.30.03.2012
7. Propozim-Vendim për miratimin e iniciativës ndërkunuale për menaxhimin e integruar të mbeturinave.
8. Draft-Programi tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025,
9. Propozim-Vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. numër P-03020-2 ZK-Shtime,
10. Propozim-Vendim për hapje të rrugës publike në Z.K – Karaqicë,
11. Informatë e përgjithshme nga DKRS,

12. Informatë nga DZHE – Sektori i bujqësisë për mbjelljet pranverore,

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje, sa u përket pikave të rendit të ditës unë jam për këtë rend të ditës, por propozoj që pikat 9 dhe 10 të hiqen nga rendi i ditës.

**z.Përparim Ramusa;** Përshëndetje, para se ta miratojmë rendin e ditës po kërkojmë një sqarim nga drejtori për propozimin e Rexhep Gashit nëse është në përputhje me ligjin ose jo.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Ne e kemi sqaruar në KPF-ë, këtu po flasim për një zonë të ndërtimit të lartë, dhe nuk e shoh problematike aty aspektin e tokës bujqësore. Ne e kemi propozimin e qartë, ajo aty është rrugë që 15 vjet dhe është e asfaltuar, ndërkaq që ne po duam që ta legalizojmë. Sa i përket Karaqicës, ne te ky rast e kemi një kërkesë për ti mundësuar palës qasje në rrugën publike sepse nuk ka qasje, ne si drejtori i kemi rekomanduar kuvendit që ta miraton, mirëpo nëse Kuvendi nuk lejon ne jemi në rregull, thjesht është punë dhe kompetencë e Kuvendit.

**z.Rahman Jakupi;** Përshëndetje, bazuar në nenin 83 të LVL-së, ne si Kuvend kemi të drejtë për me kërkuar konsultim paraprak te MAPL-ja, për propozimin e Rexhës. Ne e përkrahim propozimin e Rexhës që të shtyhen këto dy pika 9 dhe 10.

**z.Reshat Mujota;** Përshëndetje, pajtoj me propozimin e Rexhës, pika 9 ka ardhur tash dhe drejtori është mirë për me i dhënë vetit pak hapësire, dhe me u marrë me Ligjin. Ka qenë mirë që me qenë prezent këtu edhe zyrtari ligjor dhe me na sqaruar. Unë jam i sigurte se edhe në Karaqicë vendimin do ta kthen mbrapa MAPL-ja.

**z.Kadri Emini;** Përshëndetje, kërkesa për me e shty nuk është e drejtë, sepse e kemi një rekomandim të drejtorisë, e cila para se ta bjen rekomandimin e ka konsultuar edhe Ligjin. Prandaj nëse nuk është në përputhje me ligjin e kthen MAPL-ja.

**z.Përparim Ramusa;** Mos të krijohet opinioni që ne jemi kundër rrugëve. E kemi rastin në Pjetërshticë që ne i kemi informatat se e ka kthyer MAPL-ja. Është e vërtetë se në KPF-ë e kemi votuar.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Ne këtu nuk jemi duke i dhënë askujt tokë, por ne po krijojmë qasje për banorët aty, kështu që ne po themi se vetëm duhet të ketë ridestinim të asaj prone aty, e që krejt është për interes të qytetarëve.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj se në sallën e Kuvendit i kemi prezent 21 anëtarë të Kuvendit.

\***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 10 vota “Për” me 11 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”** nuk e miratoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit, që është dërguar me material.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”** miratoi rendin e ditës pa pikat 9 dhe 10 të rendit të ditës.

#### Pika 1

##### Pyetje - Përgjigje

**z.Reshat Mujota;** Pyetje për DPUKGJ-në, kurë do të filloni Kanalizimin e ujërave të zeza në një pjesë të fshatit Mollopolc, le të ma jep drejtori një afat? Në atë pjesë ujiten tokat, dhe mos të presim deri sa të rriten bimët e drithërave sepse shkaktohen dëme të mëdha? Pyetje për DPUKGJ-në, kur do të bëhet zgjidhje për kanalizimin te Kulla, edhe për një 5 shtëpi që gjenden aty të fshatit Mollopolc?

**z.Adem Ramadani;** Pyetje për Kryesuesin e Kuvendit, pse po na mungojnë Ekstrakt Procesverbalet? Pyetje për DPUKGJ-në, unë kam kërkuar për te Kodra e Bebushit me u ndërtuar diçka, e përgjigja është për krejt diçka tjetër? Pyetje për DPUKGJ-në, te Shtabi i UÇK-së në Rancë e pashë dhe mirë është që po përjetësohet, mirëpo rruga deri te Shtabi kur do të bëhet?

**znj.Rrezartë Ramadani;** Pyetje për DSHP-në, sinjalizimi është bërë në qytet, por po mungojnë pasqyrat për këndet e vdekura? Pyetje për DKA-në, a keni ndërmarrë diçka për me e irregulluar sallën sportive te Gjimnazi “Naim Frashëri” në Shtime?

**z.Muhamed Ademaj;** Pyetje për drejtorinë e Prokurimit, shumica e projekteve në fazën e prokurimit fillojnë në muajin Mars, pyetja është sa është realizuar Plani i Prokurimit deri tanë?

**znj.Zejnije Veliu;** Pyetje për DPUKGJ-në, te rruga Petrovë – Reçak, dhe te rruga “William Voker” në Shtime është ngarkuar me automjete të rënda duke e parë rrezikun që paraqesin këto mjete e sidomos në orët e hershme të mëngjesit te shkolla fillore “Emin Duraku”, a keni ndonjë projekt që këto automjete të ju sigurohet ndonjë rrugë alternative?

**znj.Albana Podvorica;** Kemi biseduar me Sekretarinë e Kuvendit që të përmirësohet mbiemri im sepse është shkruar gabimisht te Procesverbalit. Pyetje për DPUKGJ-në, në rrugën “Skender Salihaj” a është bërë ndonjë zgjidhje sepse Kontrata është ndërprerë? Pyetje për Kryetarin, keni premtuar furnizim me ujë për 24 orë, ndërkaj që banorët te Pishat po kanë problem të furnizimit me ujë, a keni bërë ndonjë zgjidhje për ta?

**z.Besnik Seferi;** Pyetje për DKA-në, qe një vit ende nuk ka printer e nuk ka as letër në shkolla, kur do të sigurohen? Pyetje për Kryetarin, rruga “Tranzit” është problem i madh, kur më në fund do të rregullohet? Pyetje për DKA-në, a ka një plan për përkrahjen e kësaj Organizate? Pyetje për DKA-në, te shkolla po ka ndalje të automjeteve në mes të rrugës, pastaj po shkojnë e po i parkojnë automjetet te oborri i stacionit të vjetër të Policisë? Pyetje për Kryetarin, ne si KPK-ë i kemi rekomanduar Kryetarit që brenda 30 shtëpive që do të ndërtohen së bashku me OJQ-në “Jetimat e Ballkanit” që 5 shtëpi të janë për komunitetin pakicë?

**z.Rexhep Gashi;** Pyetje për ekzekutivin, pse nuk po na përgjigjet në pyetjet tona? Në vitin 2015, pikërisht ishte Lëvizja për Vetëvendosje që kishte propozuar këtë pikë? Pyetje për DPUKGJ-në, kanalizimi i ujërave të zeza Godanc-Vojnovc nuk është funksional, çka keni ndërmarrë si drejtori për rregullimin e tij? Pyetje për DKA-në, çka po ndodhë me profesorët me orët e humbura për vitin 2022-2023?

**z.Përparim Ramusa;** Pyetje për DPUKGJ-në, qe 4 muaj është një kërkesë nga kryetari i fshatit Davidovc, çka është ndërmarrë në lidhje me të? Pyetje për DKA-në, si është e mundur që asnjë aparat fotokopjues nuk funksionon? Pyetje për Kryetarin, si është e mundur 16-17 muaj nuk funksionon rëntgeni në QKMF? Pyetje për Kryetarin, rruga “Tranzit”, kur do të fillon deri kur do të vazhdon kështu?

**znj.Besartë Musliu-Spahija;** Pyetje për Kryetarin, po e përsëris pyetjen lidhur me mirëmbajtjen e varrezave të Veteranëve dhe të Dëshmorëve por nuk kam marrë përgjigje? Pyetje për DPUKGJ-në, kur do ta bëni asfaltimin apo ndërtimin e ndonjë parku te shkronjat e UÇK-së?

**z.Gëzim Haxhiu;** Pyetje për DPKUGJ-në, kur parashihet rregullimi dhe ndriçimi i rrugës “Topilla” dhe “Gashi” në Godanc të poshtëm?

**z.Rahman Jakupi;** Pyetje për kryesuesin e Kuvendit, vendimi për objektin e ngushëllimeve në fshatin Pjetërshticë a është konfirmuar nga MAPL-ja? Pyetje për Kryetarin, te shtabi i UÇK-së në Rancë a keni marrë pëlqim nga pronaret e tokave për kompensimin e tyre me qellim që me vazhdua projektin? Pyetje për Kryetarin, ku janë 10 mijë euro te shtabi i UÇK-së në Rancë? Pyetje për DKA-në, a do të mbetet edhe sivjet mbajtja e semimaturës?

**z.Lumni Amrushi;** Fillimi i falënderoj Kryetarin që i ka shtruar disa rrugë te migjallarët e mi. Por pyetja është për Kryetarin, çka do të ndodhë me kazermën në Pjetërshticë?

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Përshtendetje, po mundohem të përgjigjem ashtu qysh i kamë marrë pyetjet me shkrim. Po filloj nga Ademi, ne po tentojmë që të punojmë ashtu qysh e meriton trajtimi i memorialit te Masakrës së Reçakut. Do të punohet me maturi e jo me iniciativa. Me zonjën Çeku, jemi vazhdimisht në kontakt dhe është temë e përditshme. Ne do të kemi kujdes në ndërrhyrjet që duhet bërë në kompleksin memorial. Agjensioni i memorialëve është në bashkëpunim me zyrën projektuese e cila e ka bërë edhe projektin për “Heroinat” në Prishtinë. Kjo pjesë po mendojmë që të realizohet në vitin 2024-2025. Lidhur me kompleksin duhet me u trajtua edhe pjesa te Kodra e Bebushit për ta kompletuar si projekt.

**z.Adem Ramadani;** Kërkesën e kam bërë pikërisht me 15 Janar, dhe ne kemi thënë se nuk ka asgjë te vende-ndodhja e masakrës e që ne mendojmë se duhet të ketë aty së paku një shenjë që ka ndodhur masakra. Në një takim që kemi pasur me disa pjesëtarë të Qeverisë ata na kanë thënë pse nuk po e bëni një kërkesë, kjo pra ishte arsyaja pse kemi bërë kërkesë. Ne po pajtohem se gjërat duhet të koordinohen, kërkesa janë është që kjo të mos harrohet, sepse te Kodra e Bebushit nuk ka asgjë, përvèç të disa gurëve me ngjyra që i kanë bërë banorët. Është mirë që të bëhet sa janë dëshmitarët gjallë. E di që kjo shkon me projekt konkret.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Të falënderoj Adem për dëshirën që ke shprehë për me kontribuar në këtë pjesë. Për kah rëndësia që ka ky kompleks menjëherë është pas kompleksit memorial të "Jasharajve" kështu që kjo është prioritet i yni edhe i Qeverisë së Kosovës. Këtë verë do të fillojnë punët.

**znj.Zejnie Veliu;** E dimë që në rrugën për Petrovë ka gurëthyes, dhe firmat atje duhet të punojnë dhe nuk ka mundësi tjetër, mirëpo a është duke u menduar për një alternativë tjetër për Unazën e Madhe që do të shkojë Molopollc - Petrovë - Belincë, dhe a ka mundësi reale që të futet në buxhet.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Për sa i përket pyetjes së znj.Podvorica për ujësjellësin se gjendja e ujit nuk është e mirë, pajtohem mirëpo ate që duhet thënë është edhe fakti se kështu jo të mirë e kemi gjete. Tani kemi një memorandum bashkëpunimi me OJQ-në "Katari" e cila është zotuar me participuar me 60% si dhe "KRU-Prishtina" me pjesën tjetër ku do të mundë të zgjedhim problemin e ujit për një afat më të gjatë. Po ashtu lajm i mirë është se fondi është siguruar nga OJQ "Katari", lajmin e kemi para tre ditësh. Ne jemi duke diskutuar edhe për mundësinë që ta kyçim edhe vrellen e Reqakut për sa i përket furnizimit të fshatit Reqak. Pastaj do të punojmë edhe në parandalimin e keqpërdorimeve të ujit, si masa për kursimin e ujit. Sa i përket pyetjes së Besnikut, te printerët, mua më vjen keq për mungesën e tyre nëpër shkolla, por sigurimi i tyre është kompetencë e nivelit qendror, dhe këtu është në pyetje edhe papërgjegjshmëria e operatorit ekonomik për këtë, e cila po na nxjerrë telashe si operatorë i zgjedhur nga niveli qendrorë. Ne i kërkojmë ndjesë arsimtarëve për këtë mungesë. Sa i përket rrugës "Tranzit" e di që është e keqe por fillimisht dua që t'i njoftojë qytetarët se "Tranziti" është në kompetencë të nivelit qendrorë. Detyra ime si Kryetarë për këtë është se e kemi aktualizuar dhe e kemi futur në kodin buxhetor të Kosovës me 1.7 milion euro. Nuk mundë të ndikojmë më shumë për sa i përket procedurave të prokurimit në nivelin qendrorë. Informatat i kemi që së shpejti do të bëhet përzgjedha e operatorit. Sa i përket pyetjes për komunitetin nga një shtatori do ta gjejmë një zgjidhje. Sa i përket nyjës të komunikacionit te shkolla filllore ne po punojmë me DPUKGJ-në dhe me ekspertë të komunikacionit, që ta zgjedhim këtë problem. Është e vërtetë se kemi marrëveshje me OJQ "Jetimat e Ballkanit", me të cilët jemi dakorduar për ndërtimin e 30 shtëpive. Ata e kanë formuar një komision me një anëtarë nga Komuna Shtimes dhe dy nga OJQ "Jetimat e Ballkanit", si dhe kanë bërë një data-bazë. Sa i përket kanalizimit Godanc-Gjyrkovic, për segmentin e parë janë ndarë mjetet 150 mijë euro. Ndërsa për segmentin e dytë Gjyrkovic-Muzeqinë do të fillojmë pasi të mbyllët segmenti i parë. Te Rëntgeni në QKMF-ë, siç e dini Rëntgeni atje është një pajisje e avancuar dhe për mirëmbajtjen e kësaj aparature është krijuar monopol, sepse firma e cila e bënë mirëmbajtjen e Rëntgenit është e vetme në Kosovë dhe në shpalljen tonë për mirëmbajtje nuk ka konkurruar me çmimin që e kemi paraparë ne. Sa i përket varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve Qeveria e ka ndarë detyrën për me i mirëmbajtur dhe me i ndërtuar ato. Tash e kemi një operator që kujdeset për Shtabin ndërsa për Varrezat ende jo. Sa i përket pyetjes së z.Jakupit lidhur me Shtabin e Rancës, këtë muaj do të fillojë ndërtimi, jam i lumtur për këtë projekt, sepse edhe rruga deri më 20 Qershori do të përfundojë. Ka pas problematika me pronarët e tokave, ata janë ndjerë të ofenduar me ofertat që u janë bërë më herët. Ne kemi diskutuar me ta për me filluar punën e pastaj me kërkuar shpronësimin e tokave të tyre, për këtë i kamë falënderuar e sidomos familjen Halili e cila ka kontribuar mjaftë shumë. Lidhur me 10 mijë euro që i përmendi z.Jakupi unë nuk kamë asnjë informacion tani për tani lidhur me këtë, mirëpo kur ti marrë informacionet do të përgjigjem. Sa i përket pyetjes së z.Amrushit lidhur me Shtabin në fshatin Pjetërshticë ne kemi pasur disa takime pune me Veteranët dhe kemi ardhur në përfundim se aty duhet ta mirëmbajmë qysh i ka hije, ndërsa rruga deri te shkronjat e UÇK-së nuk kemi muajt me e krye për shkake të pjerrësisë së madhe dhe ujërave atmosferik të cilët duhet të trajtohen, por sigurisht që do ta kryejmë edhe këtë. Sa i përket asfaltimit të rrugëve në fshatin Pjetërshticë, kjo tregon se ne nuk punojmë në bazë të politikave dhe afersive tjera, dhe kjo është dëshmia më e mirë për punën tonë që nuk e bëjmë me diskriminime.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Pëershëndetje, faleminderit për pyetjen Reshat, problemi që është te një pjesë e kanalizimit në Mollopolc, ne e dimë kontrata është dy vjeçare, vitin e kaluar nuk ka përfunduar krejt, këtë vit operatori ekonomik për shkake të ujërave që gjenden në atë pjesë kanë me përfunduar, mirëpo unë kompanisë i kamë dhënë vërejtje që në dy javët e para të Qershoris me përfundua atë pjesë të kanalizimit. Te kulla janë në pyetje 100 metra kanalizim ne e kemi diskutuar dhe po besoj që së shpejti do ta gjejmë një zgjidhje. Te rruga "Skender Salihaj", e cila është dy kilometra e gjatë janë

përfunduar 500 metra trotuar. Sivjet kjo do të kryhet deri te Halla Sportive. Ndriçimi përfundon në shumicën e rrugëve e sigurisht që do të përfundojë edhe në rrugën "Topilla" në Godanc.

**znj. Ylli Fejzullahu, drejtoresh e DKA;** Në shumicën e pyetjeve Kryetari dha përgjigje. Rrezarta bëri pyetje për sallën e sportit te Gjimnazi, atje është duke punuar kompania dhe sot po bëjmë një takim pune dhe do të shohim gjendjen. Sa i përket humbes së orëve, ne tani më jemi në fund të vitiit. Ndërsa sa i përket pyetjes për semimaturë ne jemi duke biseduar me drejtoret e shkollave.

**z.Grejtalb Emīni, drejtore i DPUKGJ;** Sa i përket çështjes që u ngrit për "Kodren e Bebushit" përgjigjen e dha Kryetari. Në vitin 2024 bashkërisht e fusim në buxhet dhe e rregullojmë rrugën "William Wolker", komplet për pjesën e djathtë sepse është e dëmtuar bukur shumë.

**z.Muhamet Ademaj;** Unë desha ta pyes Kryetarin për sa i përket ujtit të pajes te shkolla fillore e Petrovës, u bënë 20 vjet që tek kjo shkollë nuk ka ujë për pije, a mundet me u zgjidhë ky problem pak më shpejtë.

**znj. Adelina Beqaj;** Mua mu duk tabu fjala e Kryetarit, "nuk po muj me bëre", sepse siç e dini në fushatë ke thënë i bëjë të gjitha e bëj edhe "Tranzitin" e bëjë edhe lumin Shtimjanja. Ne po e shohim në çdo mbledhje të Kuvendit që Godanci po lulëzon, këtë e thashë duke u ndërlidhur me diskriminimin që u përmend për Pjetërshticë.

**z.Lumni Amrushi;** Kamë një kërkësë për fshatin Carralevë, ku mendojë se mundet me u bë një kyçje te Shpella e Pjetërshticës, përfaktin se është distancë e shkurtër.

**z.Përparim Ramusa;** Më vjen mirë që Kryetari e ka ndërruar qasjen, sepse komplet ka dështuar. Kryetari e pranojë që në QKMF-ë Rëntgeni nuk po mund të rregullohet. Pranimi edhe sa i përket shkollave lidhur me pajisjet e fotokopjimit është një shenjë pozitive e juaja.

**z.Rexhep Gashi;** Sa i përket DKA-së 80% të shkollave kanë humbje të orëve. Sa i përket propozimit të Lumit për projektin te shpella unë e përkrahu.

**znj. Albana Podvorica;** Për DPKUGJ lidhur me funksionimin rrugës "Skender Salihaj", mendoj se ajo pjesë e rrugës është tepër e ngarkuar tepër shumë me nxënës.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Sa i përket pyetjes përfaktin e ngushëllimeve në Pjetërshticë, MAPL-ja na ka kthy një përgjigje se është i kundërligjshëm.

**z.Rahman Jakupi;** Unë nuk morra përgjigje nga Kryetari përfundon në 10 mijë euro te Shtabi i Rancës?

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Është shqetësim real përfundon në fshatin Petrovë, mendojë se është një problem përfundon në shkakun e lartësisë kështu që po ka vështirësi përfundon me furnizua krejt fshatin përkatësisht edhe shkollën. Me projektin që e përmenda më parë do të zgjidhet çështja e ujtit edhe te shkolla. znj. Beqa e përmendi lumin Shtimjanja, është buxhetuar dhe këtë vit janë ndarë 400 mijë euro e përfundonit tjetër do të arrijë në shumën 5.4 milion përfundon 21 km. të lumit Shtimjanja. Ky fond na bënë krenar përfundonit e këtij projekti, dhe mendoj se është mirë që ti gjëzohemi këtij lajmi të gjithë. Ne në mënyrë të barabartë po sjellim me dhjetëra miliona projekte përfundonit të gjitha fshatrat në Komunën tonë, kështu që po e transformojmë rrënjosht Shtimen. Unë askund nuk thashë se është dështim projektit i "Tranzitin", sepse siç e dini "Tranzitin" e kemi gjetur në gjendje të mjerueshme. Tani më "Tranziti" është buxhetuar me 1.7 milion euro.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Po e marrim një pauzë prej 5 minutave në ora 11:15h.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Mbledhja vazhdoi në ora 11:27h. Ju njoftojë se tash e tutje nuk do ta shkelim rregulloren e punës së Kuvendit të cilën e kemi miratuar bashkërisht, dhe tani po kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

**z.Përparim Ramusa;** Nuk po kalojmë në pikën tjetër pa na e dhënë fjalën edhe njëherë sepse Kryetari na i ka përmend emrin dhe ne duhet ta përfundojmë diskutimin e pastaj shkojmë në shqyrtimin e pikës tjetër.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Lexoi nenin 7 të rregullores së punës së Kuvendit dhe në vazhdim tha z.Ramusa po ta jap fjalën në emër të grupit parlamentar të PDK-së.

**z.Përparim Ramusa;** Zoti Kryesues kërkojmë që përfundonit të femrat të keni më shumë respekt sepse nuk është hera e pare që po e një një farë mosrespektim ndaj femrave të Kuvendit. Kryetari po rren e që në ditët e sotit irren cit po i thonë strateg, ndërkëq që Adelina e ka votuar vendimin përfundonit.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Te çështja e ofendimeve mund të ju them se nuk është në natyrën time përfundonit, dhe këtu e kemi një rregullore të punës e cila nuk ka të bëjë me gra e harrta por me shkelje

të irregullores pa marrë parasysh gjininë. Ju e patë të gjithë se si znj. Adelina e ndez disa herë rrreshth mikrofonin pa ja dhanë fare fjalën Kryesuesi.

## Pika 2

Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Lidhur me këtë pikë ne kemi diskutuar gjatë, kjo pikë pra vjen qe 3 herë në Kuvend. Rekomandimi i KPF-së është pozitiv, dhe rekomandon për miratim. Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja japim Kimete Ukaj.

**z.nj.Kimte Ukaj, ZKF;** Përshëndetje, unë nuk dua që ta zgjati shumë prezantimin sepse listën e ndarjes së mjeteve financiare e keni marrë me kohë dhe e keni pa ndryshimet që janë bërë, mbi bazën e të cilës e kemi edhe rekomandimin e KPF-së. Prandaj unë ju ftoj që ta miratoni.

**z.Përparim Ramusa;** Është hera e tretë që vjen në Kuvend. Kanë kërkuar mjete për vetura e lloks. Ne i kemi kërkuar që 40.000 euro me shkua për sport. Ne jemi takort që shpronësimet të bëhen varësisht nga kërkesa që vjen.

**z.Besnik Seferi;** U përmend që e kemi diskutuar, më duhet të them se askush nuk ka qenë kundër ndryshimit për ridestinimin e mjeteve financiare, por vetëm është shty pa ndonjë arsy. Më në fund më vjen mirë që kanë ardhur propozimet për ndryshime, sepse kudo që shkojnë ato mjete janë për të mirën e qytetarëve.

**z.Reshat Mujota;** Unë jam "Për" me kalua kjo listë. Unë më herët kam thënë që 15.000 euro me shkua për arsim, mirépo sidoqoftë unë jam për me kalua kjo listë.

**z.nj.Rrezartë Ramadani;** Përshëndetje, propozimi im është që te shuma e paraparë për DKRS-në të mbeten 5000 euro, ndërsa që 20.000 euro të shkojnë në DSHMS-ë dhe 20.000 euro në DKA-në.

**z.Rexhep Gashi;** Te kolona e 12 unë kamë kërkuar për me shkua 20.000 euro. Unë i falënderoj asamblistët që më përkrahën. Unë jam "Për" me e votuar këtë listë të ndarjeve të mjeteve.

**z.Adem Ramadani;** Pajtohem me këtë listë të ndarjeve për me i qitë 40.000 euro te sporti. Klubi sportiv "Vjosa" ma kanë pru një listë që i kanë 35.000 euro shpenzime në vit. Unë kërkoj që të ndahan 15.000 euro për "Futsallin".

**z.Hamëz Tërshani;** Përshëndetje, kemi kërkesa nga klub "Vjosa". duhet ta kemi parasysh "Futsallin" pastaj klubin e Volejbollit, Hendballit. Unë rekomandoj për me u marrë parasysh fakti se duhet me i motivuar ato vajza e djem për me u marrë me sport. Prandaj unë jam për këtë listë të ndarjeve buxhetore.

**z.nj.Adelina Beqaj;** Në fillim jemi dakorduar me drejtorin që për QKMF të specifikohet blerja e veturës.

**z.Përparim Ramusa;** Qëndrojmë pranë rekomandimit të KPF-së. Kërkojmë që të prioritizojnë klubet me shpenzime më të larta.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Vjosa e ka tërhequr kërkesen.

**z.Muhamed Ademaj;** Unë nga kolegët po kërkoj për me i nda 20.000 euro për sigurimin e ujit të pijes për shkollën fillore në Petrovë, dhe 20.000 euro le të mbesin për sport. Kërkoj mirëkuptim nga kolegët që ta votojnë këtë propozim timin.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Dua të sqaroj edhe një herë se këto mjete nuk mund të ndahan për kode të reja buxhetore, por vetëm për kodet ekzistuese të projekteve.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim"** miratoi vendimin, për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar 2022 në vitin aktual 2023, si dhe rritja e kufirit të hyrave sipas tabelës në shumën totale 352,849.2 €.

## Pika 3

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.

**z.nj.Kimte Ukaj, ZKF;** Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026, do të shkojë në diskutim publik. Komiteti për Politikë dhe Financa është bartëse e procesit të diskutimit publik, dhe ata duhet të marrin pjesë në debatet që do të organizohen. Dokumentin e Draft KAB-it e keni marrë dhe e keni lexuar, kështu

që unë do të lexoj vetëm të dhënët kryesore, pastaj nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem. Siç e dini dokumenti i KAB-it është vetëm një draft, dhe ky gjatë diskutimit ka mundësi të ndryshojet dhe të përmirësohet. Ju ftoj që ta votoni vendimin për diskutim publik.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Kryetari e ka cekë se procesin e diskutimit publik duhet ta zgjerojmë në se cilën shkollë e fshat do të shkojmë, kështu që bashkërisht do ta bëjmë një dokument gjithëpërfshirës, ku do të merren parasysh të gjitha kërkesat e propozimet e arsyeshme.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2024-2026, për afatin prej 15 ditësh. Bartës të organizimit të aktiviteteve për procesin e diskutimit publik është Zyra Komunale e Financave, Komiteti për Politikë dhe Financa, si dhe Zyra për Informim.**

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Tani shkojmë në pauzë të drekës në ora 12:02h, dhe kthehem prape në mbledhje në ora 13:00h.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Vazhdojmë me mbledhjen në ora 13:35h

#### Pika 4

##### Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ju e keni marrë një dokument nga MAPL-ja ku ka dhënë sqarime për mënyrën e zëvendësimit të anëtarit të KPF-së, si komitet obligator. Po e hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Kadri Emini;** Sipas materialit nuk kemi një vendim final, dhe nuk kemi një vendim nga MAPL-ja, por e kemi një opinion. Opinion i MAPL-së është edhe i imi, por ju duhet me kërkua nga MAPL-ja konfirmimin e ligjshmërisë të vendimit të Kuvendit Nr.01/76.

**z.Reshat Mujota;** Pasi që po përmendet emri im po e marr fjalën. Interesat personale kapak na shtinë në rrugë jo të drejtë. Unë e kam U.A.-2020 dhe po ua lexoj mënyrën se si zgjidhen Komitetet. Nëse po thuani se neve na takon atëherë pse nuk po e bëni. Propozimi im ka qenë për Rexhep Gashin. Për kuotën gjinore mundet edhe me e kthyer MAPL-ja. Mendimi im është se unë do ta kërkoh votën nga të gjithë kuvendarët për anëtarë të KPF-së. Besoj se e jap kontributin sepse e kamë një përvojë. Loja politike le të ndalet, nuk është punë e numrave por e kontributit. Sa i përket plotësimit të kuotës gjinore, nuk jam i obliguar as unë e as opozita për me e plotësuar kuotën. Unë nuk tërhiqem nga kandidatura. MAPL-ja nuk e kthen vendimin për shakat të Reshatit. Nuk kërkoh të shtyhet pika dhe nuk tërhiqem.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë në fillim kam treguar se Udhëzimi Administrativ nuk e lejon një zgjedhje të tillë. Edhe diçka desha e them, Vetëvendosja nuk është kundër Reshatit dhe kundër askujt tjetër por ne jemi këtu për ta zbatuar Ligjin. PDK-ja i ka 3 anëtarë, 2 meshkuj dhe 1 femër, dhe e ka kryer punën e saj. Pra siç e dini është një formulë matematikore e paraparë me ligj për zgjedhjen e KPF-së. Mirëpo tani këtu po bëhet fjalë për zëvendësimin e një anëtar që ka dhënë dorëheqje.

**z.Reshat Mujota;** MAPL-ja vetë e ka shkelur Ligjin për 3 muaj ditë. Unë jam këshilluar edhe me Avokatin tim. Për me i bërë numrat ju keni bërë lëvizje me Heroinën. Krejt asamblistët e Vetëvendosjes kanë votuar. unë po kërkoh këtu që ju ta qitni edhe kundër kandidatin dhe po kërkoh që ta qitni në votim.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Mos më shtyni për me qitë në votim diçka që është e kundërligjshme. Unë kisha kërkuar nga ju që me e zhbllokuar këtë pikë le të shkojë dhe të ecim tutje përpara. Nuk është në rregull që edhe pas tri seancave të Kuvendit prape me mbete këtu tri orë duke diskutuar për një pikë.

**z.Përparim Ramusa;** Desha me e pyet Kryetarin se a ka mundësi me u bë ankesa përmes zyrës së Kryetarit. Edhe tjetra kur është zgjedhur ajo nuk ka qenë në Vetëvendosje.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Kryesuesin e kisha lutar që mos të bien nën arrogancën e numrave, por ta zbatoi ligjin. Ne nuk jemi këtu në tregun e pemëve, por në Kuvend ku duhet të zbatohet ligji dhe rregullorja e punës së Kuvendit, dhe nuk duhet të qiten në votim propozime të kundërligjshme. Ju po e dëmontri me qëllim interesin e qytetarëve, por sigurisht që askush nuk mundet me ndalu zbatimin e ligjit dhe interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

**z.Lumni Amrushi;** Sa i përket kësaj pike PDK-ja është në rregull me anëtarët e KPF-së.

**z.Besnik Seferi;** Po më vjen keq nga këto diskutime, nëse pra paska qenë gabim, pse atëherë edhe ju si PDK-ë po bëni të njëjtat gabime. Zyrtari Ligjor pse nuk është në mbledhje, për të na sqaruar mirë këtë situatë.

**z.Rexhep Gashi;** Nuk është funksionale KPF-ja qe 3 muaj. Më ka ardhur një shkresë, në ankesën e juaj. Unë e kamë propozuar Reshat Mujotën për anëtar të KPF-së, duke u bazuar në rrëthanat që asamblist ja në fjalë ka qenë në Vetëvendosje. E kemi një ekzekutiv të mrekullueshëm e krisnja punës. Çikjo letër është antiligjore.

**z.Reshat Mujota;** në jam anëtarë i KPF-së me votën e zgjedhur, dhe ti kryesues duhet me më thirre në mbledhje. Në punën e mirë kamë me të thanë puna e mbarë. Po merrni njerëz nga komunat tjera, e unë e paguaj avokatin me paret e mijë. Unë jam i ligjshëm, por ti ke bërë vepër penale që nuk më ke thirre në mbledhje.

**z.Hamëz Tërshani;** Pa pikë nevoje kemi ardhur deri në këtë pikë. Për mua shqetësuese janë 3 sende. Zgjedhja e Reshatit është e ligjshme, ti Kryesues ke gabuar që nuk e ke thirre Reshatin në mbledhje. Vendimi i Kuvendit është i ligjshëm. Unë kam menduar se e keni kaluar këtë far qasjen e juaj (ne-ju). Mendoj se duhet ta kemi një vendim të MAPL-së.

**z.Albana Podvorica;** Më vjen keq për një komen të Kryetarit, nuk bën me na fy, nëse ke diçka personalisht me dikën thuaja, por jo me na përfshi të gjithëve.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Të gjithë duhet ta dimë se Kuvendi nuk është vendi ku siç thuhet fontanë e dëshirave, duke vepruar, hajt se mos po ja qëllojmë. Këtu duhet respektuar ligjin dhe rregulloren. Unë nuk përmëndem emër a mbiemër, por thash se nuk bën askush me krijuar bllokada.

**z.Rrahman Jakupi;** Ti po qon msit për me i bërë votat. Ky dokument është opinione nuk është vendim. I keni gjithë këta juristë e po na vinë vendime të kundërligjshme. Kadriu e përmendi mirë për me shty.

**z.Përparim Ramusa;** Kryetar, nuk i thuhet Kuvendit me atë fjalor, ke këtu vajza të dëshmorëve, është mirë me kërkua falje.

**z.Kadri Emini;** Është mirë që ne ta presim rekomandimin e MAPL-së

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit, prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht vendosi që pika e rendit të ditës me numër 4 "Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri", të shtyhen për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit, me arsyetimin që Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, duhet me na dhënë sqarimin e saktë me Rekomandim (jo me përgjigje në kërkësë) nëse është ose jo në përputhje me Ligjin, Vendimi i Kuvendit të Komunës së Shtimes me numër, Npi – 01/76 i datës 15.03.2023, " VENDIM për plotësimin e anëtarës të Komitetit për Politikë dhe Financa, znj.Heroina Selmani nga Shtimja me zgjedhjen e anëtarit të ri, z.Reshat Mujota nga Mollopolci".

### Pika 5

Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë,

2023/2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Përparim Ramusa;** Ne e propozojmë për Komision znj.Albana Podvorica.

**z.Besnik Seferi;** Ne e propozojmë z.Muhamet Ademaj.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj Kuorumin prej 16 anëtarëve të Kuvendit, prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 14 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim" miratoi vendimin, për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë për vitin 2023/2024 si vijon: znj.Albana Podvorica dhe z.Muhamet Ademaj.

### Pika 6

Propozim për ndryshimin e nenit 3 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë Npi-01/60  
dt.30.03.2012

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 18 anëtarëve të Kuvendit, prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi plotësimin e nenit 3 të Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për studentë, 01nr.06/570-60 të datës 30.03.2012, me fjalët si vijon:

1. Te neni 3 i rregullores pas fjalëve “dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë” shtohen edhe fjalët “dhe jashtë vendit”.

### Pika 7

Propozim-Vendim për miratimin e iniciativës ndërkomunale për menaxhimin e integruar të mbeturinave

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ky propozim-vendim është vetëm sa i përket hapjes së mundësisë për fillimin e iniciativës ndër komunalë në fushën e menaxhimit të mbeturinave, në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 17 anëtarëve të Kuvendit, prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për miratimin e Iniciativës Ndër komunalë për Menagjimin e Integruar të Mbeturinave, në mes komunave si vijon:

1. Komuna Ferizaj, 2. Komuna Gjilan, 3. Komuna Kamenicë, 4. Komuna Viti, 5. Komuna Kaqanik, 6. Komuna Hani i Elezit, 7. Komuna Shtime, 8. Komuna Shtërpc, 9. Komuna Partesh, 10. Komuna Kllokot, 11. Komuna Ranillug, 12. Komuna Novobërd.

### Pika 8

Draft-Programi tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 18 anëtarëve të Kuvendit, prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më 31.05.2023, unanimisht, miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Programin tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes. Bartës të procesit të diskutimit publik janë: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komisioni i hartimit të programit, dhe Zyra për Informim.

### Pika 9

Propozim-Vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K.  
numër P-03020-2 ZK-Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalë për prezantimin e kësaj pike ja dha Albana Fazliut.

znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS; Përshëndetje, materialin për këtë pikë e kemi marrë me kohë në formë të shkruar, prandaj unë nuk do ta levojë por nëse ka ndonjë pyetje unë jam e gatshme të përgjigjem. (Shih dokumentin).

zpj.Albana Potdvorica; Në bazë të informatës shihet se pak ka pasur aktivitete, për të mos thënë fare. Kam një pyetje se cilat OJQ kanë marrë pjesë në aktivitet e 17 Shkurtit.

Pyetja e dytë te shfaqja “Tom&Jerry”, a ka kushtuar 800 euro.

zpj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS; Përgjigen e keni në informatë për pyetjen e parë, ndërsa për pyetjen e dytë përgjigjen do ta merrni me shkrim.

z.Përparim Ramusa; Nuk e di se për çka ka lidhje që në informatë me përmend shkëlqesia e saj znj.Osmani ose shkëlqesia e tij z.Kurti. Tjetër herë na i sjellë aktivitetet se çka keni bërë ju.

zpj.Adelina Beqaj; Po ndërlidhem te kopshti “Albiona Asllani”, thatë se keni kontribuar edhe ju si Komunë atëherë pyetja ime është pse ka qenë problem transporti i fëmijëve. Njëri nga premtimet e juaja ka qenë edhe mirëmbajta, e aty sa e pashë unë përvëç mbeturinave kishte edhe demolime.

**znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS;** Unë kamë thënë se transportin nuk mundemi me siguruar. Ka qenë kërkesë e edukatoreve që me marrë pjesë edhe fëmijët. Te Shtëpia e Kulturës e di që ka rrjedhje të ujtit nga pullazi. Unë besojë se në KAB do të përfshihet edhe kjo çështje.

**z.Muhamed Ademaj;** E kemi lexuar informatën. Unë kërkojë nga drejtoria që sa më shumë me u organizua aktivitete për rininë me qëllim mos me shkua nëpër kafiqa edhe rrugë të këqija.

#### Pika 10

##### Propozim-Vendim për hapje të rrugës publike në Z.K – Karaqicë

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalë për prezantimin e kësaj pike ja dha Kastriot Shabani.

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Përshëndetje, meqenëse materialin e keni marrë me kohë dhe po besojë e keni lexuar unë nuk do ta lexojë informatën, por ju ftojë që nëse ka pyetje ti paraqitni ato dhe unë do të përpinqem ti përgjigjem (shih dokumentin).

**z.Rexhep Gashi;** Mua materiali më ka ardhur para 1 muaji i njëjtë material pa asnjë ndryshim. E kemi kërkuar një listë të përfituesve të IADK-së.

**znj.Adelina Beqaj;** Për kolektorin e ujërave të zeza shumë pronarë të tokave janë dëmtuar, kur do të bëhet kompensimi i këtyre pronarëve?

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Ne e kemi dërguar në Ministri një listë të pronarëve të dëmtuar në bujqësi dhe kemi vërejtje nga auditori se ne nuk mundemi me i subvencionuar. Tash palët kanë bërë ankesë në Gjykatë dhe po presin një vendim nga Gjykata, mirëpo ne nuk mund të veprojmë më shumë.

**znj.Adelina Beqaj;** A e dini sa është vlera e dëmit të shkaktuar?

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Siç e thashë për pagesën e dëmeve nuk mund ta bëjmë sepse nuk kemi kod buxhetor dhe për këtë arsyе nuk mund ti kompensojmë. Komuna e ka bërë vlerësimin e dëmeve, që tani përfundon nuk e di shumën e saktë.

**z.Muhamed Ademaj;** Faleminderit për informatën, si dhe të përgëzoj për punën për sa i përket shtrimit të rrugëve bujqësore me zhavorr. Kanë filluar me tha pishat për shkak të ujërave të zeza, unë po kërkoj që me ndërmarrë diçka lidhur me kanalizimin.

**z.Reshat Mujota;** Unë kamë pyetje shumë por do ti sjelli me shkrim. Për farë të misrit kanë qenë të paraparë dy thasë farë me 50 mijë kokrra për hektar. Sa hektar janë mbjellë me misër, a janë 950 hektar apo jo. Unë kamë pa që të njëjtës familje kanë aplikuar dy persona. Sipas kësaj metode nuk mund të përkthehen në sipërfaqe. Sa është numri i përfituesve sepse lajmi ishte për 30 përfitues. Unë po dua që mua me mu përputhë të dhënat e kësaj liste me të dhënat e listës së Ministrisë.

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Ne kemi pasur një Komision i cili ka punuar mbi bazën e kriterieve. Përfitues të IADK-së janë 29 fermerë.

**znj.Albana podvorica;** Te kontrata për qenët endacakë a parashihet të rrite numri i geneve endacakë?

Pyetja e dytë a keni bërë vlerësimin e dëmeve dhe a keni mundësi me i mbulua shpenzimet nga Komuna?

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Nuk e shohë të arsyeshme me parapa mjete komunale për qenët endacakë pasi që me ta merret niveli qendrorë. Komisioni në bashkëpunim me DSHP-në i ka bërë vlerësimet e dëmeve dhe nga DZHE është vetëm një anëtarë i Komisionit përfushëm e bujqësisë.

**z.Kadri Emini;** Kësaj here drejtorin po e kursejë nga lëvdatat. Ligji për marrëdhëniet detyrimore e obligon Komunën për me i kompensua dëmet nga vërvshimet. Për ata 21 që janë refuzuar cilat kanë qenë arsyet e refuzimit të tyre.

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Aplikuesit kanë qenë të gjithë nga Komuna janë.

**z.Reshat Mujota;** Unë mendojë se më mirë është me shkua me pagesa direkt për çdo fermerë. Sepse në këtë formë që është bërë ju i keni ndihmuar bizneset e jo bujqit.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Te projekti i geneve endacakë a i keni inspektuar se a po e bëjnë punën e tyre si duhet?


**znj.Adelina Beqaj;** Për shpërndarjen e serrave nuk e di kush ka qenë në Komision. Një person ka aplikuar dhe ka thënë se nuk ka pas as Komision.

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Komision ka pas dhe në përbërje të Komisionit kanë qenë Safet Brahimi – KK Shtime, Merita Emini – KK Shtime, Faton Shatmani – nga fshati Belinc, Tafil Hasani –

KK Shtime dhe Neriman Ismajli Fermer nga fshati Godanc i epërm. Në procesin e ndarjes nuk ka pasur asnjë ankesë. Ka pas 280 aplikues por kanë përfituar vetëm 40 fermerë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e Kuvendit e përfundoi në ora 15:52h.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi

